



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E STUDIMEVE

Nr. 1638 Prot.

Tiranë, me 18. 07. 2002

L Ë N D A: Për unifikimin e praktikës së ndjekjes penale, etj.

**PROKURORIVE PRANË
GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË**

**PROKURORIVE PRANË
GJYKATAVE TË APELIT**

**GJITHË DREJTORIVE
KËTU**

Me synim, për të realizuar sa më mirë veprimtarinë e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, në strukturën e kësaj zyre, me urdhrin Nr. 21 datë 3. 07. 2002, është krijuar Drejtoria e Studimeve.

Disa prioritete kryesore, të kësaj drejtorie, për të cilat kërkohet edhe angazhimi i Juaj, janë në këto drejtime:

- 1. Përgatitja e akteve normative të Prokurorit të Përgjithshëm**, si: projekt urdhra, projektudhëzime, projektregullore, etj, për t'iu dërguar prokurorive të të gjitha niveleve.

Për realizimin e këtij prioriteti, **drejtuesit e strukturave të kësaj zyre dhe të prokurorive të të gjitha niveleve, deri me datë 30 shtator 2002**, duhet:

- të verifikojnë dhe rivlerësojnë aktet normative në fuqi, të viteve 1995 - 2002 dhe të propozojnë ndryshimet, plotësimet apo rigrupimet e duhura të tyre, duke i përqasur me ndryshimet ligjore përkatëse.
- të vlerësojnë nevojat e tyre, për nxjerrjen e akteve të reja normative, që rrjedhin mbështetur në K. Pr. Penale dhe në ligjet: "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në R. Sh", "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", "Për ekzekutimin e vendimeve penalë" etj, akte të cilat mund të jenë individuale të Prokurorit të Përgjithshëm ose të përbashkëta me drejtues të institucioneve të tjera, dhe të bëjnë propozimet përkatëse.

2. Përgjithësimi i përvojës negative ose pozitive, me synim, unifikimin e praktikës së ndjekjes penale në shkallë vendi dhe shmangien e gabimeve ligjore, në ushtrimin e funksioneve të prokurorit.

Drejtuesit e strukturave të kësaj zyre dhe të prokurorive të të gjitha niveleve, në dinamik dhe në vazhdimësi, duhet t'i dërgojnë, Drejtorisë së Studimeve, informacione, pyetësorë, përgjithësime, konkluzione, tema ose botime, lidhur me:

- problemet dhe vështirësitë kualifikuese ose interpretuese, që ndeshen prokurorët, në praktikën e zbatimit të ligjit penal dhe procedural penal ose ligje të tjera, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre;
 - përvojën pozitive, në ndjekjen penale në hetim ose në ngritjen e akuzës në gjyq, për procedime të rëndësishme ose me probleme;
 - përvojën negative, të evidentuar në studimin dhe/ose kontrollin e procedimeve penale, si dhe në inspektimet e pjesshme apo të përgjithshme;
 - rastet e procedimeve disiplinore: për prokurorët të shqyrtuara në Këshillin e Prokurorisë dhe për oficerë ose agjentet e Policisë Gjyqësore të shqyrtuara në Komisionet Disiplinore, si dhe masat përkatëse të marra për shkeljet ligjore të tyre.
- 3. Kryerja e kërkimeve shkencore, analizave, raporteve, temave dhe studimeve,** si drejtori dhe/ose në bashkërendim me shkollën e Magjistraturës dhe Fakultetin e Drejtësisë, etj. duke tërhequr konkluzione mbi treguesit e punës dhe/ose të dhënat statistikore:

- për tendencat dhe shtrirjen e veprave penale ose grup veprash,
- për treguesit e punës së prokurorëve, në shkallë vendi dhe në rrethe ose zona të veçanta;
- për politikën e procedimit penal në hetimet paraprake, ngritjen e akuzës dhe kërkesat e prokurorëve për lloje e masa dënimi në përfundim të shqyrtimit gjyqësor;
- për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit, në prag të mbylljes së vitit gjyqësor, etj;

Për realizimin e këtij prioriteti, **drejtuesit e prokurorive të të gjitha niveleve, duhet:**

- që deri me datë 20. 09. 2002, të dërgojnë në Sektorin e Statistikës, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, mendime dhe/ose propozime, për ndryshime, përmirësime ose plotësime, në sistemin statistikore, lidhur me treguesit e veprave penale dhe treguesit e punës së prokurorëve pranë gjykatave sipas nivele;
- duke filluar me 9-mujorin e këtij viti, krahas statistikës 3-mujore, 6-mujore, 9 mujore dhe vjetore, çdo drejtues prokurorie, të dërgojë në Drejtorinë e Studimeve edhe një raport analitik me të dhëna:
 - për tendencat dhe shtrirjen e veprave penale ose grup veprash në atë rreth, të ilustruar dhe me rastet më tipike;
 - për treguesit e punës së secilit prokurorë, në ushtrimin e funksioneve të tyre;
 - për politikën e procedimit penal në hetimet paraprake, ngritjen e akuzës, kërkesat e prokurorëve për lloje e masa dënimi në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, apelimet, rekursat, etj.
- propozime për ndryshimet e nevojshme të akteve ligjore ose nënligjore, që lidhen me veprimtarinë e Prokurorisë dhe/ose të Policisë Gjyqësore.

4. Hartimi i programeve të trajnimit të prokurorëve, si drejtori, dhe/ose në bashkërendim me Shkollën e Magjistraturës, si dhe me institucione të pushtetit gjyqësor, bazuar:

- në prioritetet ose shqetësimet e praktikës së procedime penale, si dhe;

në bashkërendim me Drejtorinë e Personel/Inspektimit, etj. ndjek trajnimin vazhdues të tyre.

Drejtuesit e strukturave të kësaj zyre dhe të prokurorive të të gjitha niveleve, deri me datë 10. 09. 2002, duhet ti dërgojnë, Drejtorisë së Studimeve, mendime:

- për nevojat e trajnimit të prokurorëve, duke grupuar dhe temat që mendohet se janë më imediate për tu trajtuar;
- për nevojat e trajnimit të Policisë Gjyqësore, veçanërisht të oficerëve pranë seksioneve të prokurorisë, duke grupuar dhe temat që mendohet se janë më të nevojshme;
- mënyrën e organizimit të këtyre trajnimeve që mendohet se mund të jetë më me efektivitet, etj.

Me këtë qarkore të njihen të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve pranë prokurorive.

Drejtuesit e Prokurorive pranë Gjykatave të shkallës së parë, Gjykatave të Apelit dhe **drejtorët e drejtorive** të 2yrës së Prokurorit të Përgjithshëm, të marrin masat e duhura organizative,

- **për thithjen e mendimeve të kërkuara,** përkatësisht nga secili prokuror ose oficer i policisë gjyqësore, si dhe;
- **për përgatitjen dhe dërgimin,** Drejtorisë së Studimeve, të materialeve të specifikuara brenda afateve të përcaktuara.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU



